



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER
NJËSIA E PROKURIMIT



Nr. _____ prot.

Fier, më 02.05.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje Protoksid Azoti N2O ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 24112200-4

**VLERA E FONDIT LIMIT: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë
Marrëveshjes Kuadër: 4 956 000 (katër million e nëntëqind e pesëdhjet e gjashtë mijë)
Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitalit Rajonal “Memorial” Fier” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4,
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Kriteri Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë **3 (tre) viteve** te fundit **(2022, 2023, 2024)**, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 1 800 000 lekë**, (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në piken 1 dhe piken 2/c të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedrat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar... ”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet **tatimore** brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.*

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.1 : Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të ulët se **900 000 lekë** (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nuk është më e madhe se 20% e vlerës së përllogaritur të kësaj kontrate).

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 55 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në të cilin është e përcaktuar se: [...] 4. (b) *Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Kriteri 2.3.2 Ofertuesi të paraqesë Autodeklarate mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) për secilin artikull.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese/mbajtësin e autorizimit për tregëtim për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pikë 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Kriteri 2.3.3: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar. Në rast se OE është vet prodhues, duhet të paraqesë vetedeklarim me shkrim.

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës. (Dokumentat duhet të jene te perkthyer dhe te noterizuara në gjuhën shqip).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar për të njohur origjinën e mallrave dhe për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 8 te VKM 285 datë 19.05.2021.

Kriteri 2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese dokumente qe vërteton se shoqëria ka ne pronësi (ose kontrata qeraje), brenda territorit te Shqipërisë tankera për ruajtjen e gazrave mjeksorë me një kapacitet minimumi 300 kg, ose te ketë linje prodhimi ne vend. Këto te jene gjendje ne momentin e zhvillimit te tenderit.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77, pika 1/c të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, me qëllim garantimin e furnizimit me këtë mall për shkak të vetë specifikave të tij dhe rëndësisë që ka për funksionimin normal të institucioneve spitalore si dhe për të provuar kapacitetin teknik të OE me qëllim përmbushjen e kontratës. Sasia e protoksidit te azotit të kërkuar, minimumi 300 kg, është në përputhje me nevojat e spitalit. Me qëllim që të mos krijohen vonesa dhe defekte në furnizimin e spitalit me protoksid azoti , i cili është jetik për këto institucione.

Kriteri 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vërtetim për regjistrim dhe kontroll nga inspektoriati i pajisjeve nen presion, për plotësimin e kushteve teknike dhe te sigurisë konform legjislacionit ne fuqi qe vepron ne RSH.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 40 pika 6/c të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit mund të kërkojen dëshmi për realizimin e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe është ne perputhje me objektin e kontrates. Është patur parasysh se protoksid azoti , mund të tregtohet i ambalazhuar me bombola, të cilat duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë konform legjislacionit për enët nën presion.

Kriteri 2.3.6 Kërkojen të paraqiten katalogë teknikë dhe/ose skedë teknike për mallrat e ofruara. Në katalogë/skedë teknike, specifikimet teknike të mallit duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas specifikimeve teknike të kërkuara. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST (Dokumentet duhet te jene te perkthyer dhe te motorizuara).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar për të vërtetuar që operatori vepron sipas legjislacionit ne fuqi bazuar në nenin 40, pika 8 te VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar si dhe plotëson kërkesat e AK .

Specifikimet Teknike:

PËRBËRËSIT	NJËSIA	VLERAT EUROPIANE
N ₂ O	%	Jo më pak se 99,5%

N ₂ O	%	Jo më shumë se 0,0001%
N ₂ O	%	Jo më shumë se 0,0001%
H ₂ O	%	Jo më shumë se 0,4 mg/litër
NH ₃	%	Jo më shumë se 0,001%
CO ₂	%	Jo më shumë se 0,01%
CO	%	Jo më shumë se 0,001%
Protoksidi i Azotit të jetë me bombula	kg	27

- Kontraktuesi ka për detyrë të mirëmbaje, kolaudojë dhe të riparojë bombolat me shpenzimet e veta në përputhje me rregulloren përkatëse të miratuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI).
- Çdo furnizim të shoqërohet me flete analize
- Transportimi dhe shkarkimi i bombulave të kryhet nga kontraktuesi deri brenda në magazinën e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e

kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet sipas DST-se.

Argumentimi: janë vendosur bazuar te procesverbalit nr. 478/1 date 28/04/2025 te komisionit te hartimit i specifikimeve teknike dhe perllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt: “ Blerje Protoksid Azoti N2O ” si dhe ne perputhje me nenin 4,pika 38/b, nenin 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT: